Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike.....

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve.....

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikon e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	6	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia Ne cope	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.	Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve				
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike të ashensoreve në mirembajtje:

Specifikimet teknike të ashensorit 1

Tipi : Kleemann

Shpejtësia (meter/sekond): 1.0

Peshembajtja (kg): 1000

Kapaciteti (persona): 13

Numri I ndalesave: 8

Gjatesia e udhetimit (mm): 23700

Thellesia e gropes (mm): 1400

Headroom: 3600

Modeli I Kabines: Panoramike + Inox Satin

Dimensionet e kabines 1400 x 1600 x 2075

Dyshemeja e kabines: Granit

Tavani i kabines: Inox + Plexiglass

Ventialator ne kabine : I perfshire

Numri i dyerve ne kabine: 1

Gjerësia e dyerve (mm): 900

Lartesia e dyerve (mm): 2000

Dimensioni i kasave anesore(mm): 120

Dimensioni i kases lart(mm): 210

Hapja e dyerve: Teleskopike 2 panele

Materiali i deres se kabines: Inox Satin

Materiali i dyerve te katit: Inox Satin

Motori: Kleemann

Elektronika: Kleemann

Emergjenca: Automatike

Specifikimet teknike te ashensorit 2

Tipi : Kleemann

Shpejtesia (meter/sekond): 1.0

Peshembajtja (kg): 1000

Kapaciteti (persona): 13

Numri I ndalesave: 8

Gjatesia e udhetimit (mm): 23700

Thellesia e gropes (mm): 1400

Headroom: 3600

Modeli i Kabines: Panoramike + Inox Satin

Dimensionet e kabines 1400 x 1600 x 2075

Dyshemeja e kabines: Granit

Tavani i kabines: Inox + Plexiglass

Ventilator ne kabine : I perfshire

Numri i dyerve ne kabine: 1

Gjerësia e dyerve (mm): 900

Lartesia e dyerve (mm): 2000

Dimensioni i kasave anesore(mm): 120

Dimensioni i kases lart(mm): 210

Hapja e dyerve: Teleskopike 2 panele

Materiali i deres se kabines: Inox Satin

Materiali i dyerve te katit: Inox Satin

Motori: Kleemann

Elektronika: Kleemann

Emergjenca: Automatike

Specifikimet teknike te ashensorit 3

Tipi : Kleemann

Shpejtesia (meter/sekond): 1.0

Peshembajtja (kg): 1000

Kapaciteti (persona): 13

Numri I ndalesave: 9

Gjatesia e udhetimit (mm): 27300

Thellesia e gropes (mm): 1400

Headroom: 3600

Modeli I Kabines: Panoramike + Inox Satin

Dimensionet e kabines 1650 x 1450 x 2075

Dyshemeja e kabines: Granit

Tavani i kabines: Inox + Plexiglass

Ventialator ne kabine: I perfshire

Numri i dyerve ne kabine: 1

Gjerësia e dyerve (mm): 900

Lartesia e dyerve (mm): 2000

Dimensioni i kasave anesore(mm): 120

Dimensioni i kases lart(mm): 210

Hapja e dyerve: Teleskopike 2 panele

Materiali i deres se kabines: Inox Satin

Materiali i dyerve te katit: Inox Satin

Motori: Kleemann

Elektronika: Kleemann

Emergjenca: Automatike

Specifikimet teknike te ashensorit 4

Tipi: Kleemann

Shpejtesia (meter/sekond): 1.0

Peshembajtja (kg): 1000

Kapaciteti (persona): 13

Numri i ndalesave: 8

Gjatesia e udhetimit (mm): 24100

Thellesia e gropes (mm): 1400

Headroom: 3600

Modeli I Kabines: Panoramike + Inox Satin

Dimensionet e kabines 1650 x 1450 x 2075

Dyshemeja e kabines: Granit

Tavani i kabines: Inox + Plexiglass

Ventialator ne kabine: I perfshire

Numri i dyerve ne kabine: 1

Gjerësia e dyerve (mm): 900

Lartësia e dyerve (mm): 2000

Dimensioni i kasave anesore(mm): 120

Dimensioni i kases lart(mm): 210

Hapja e dyerve: Teleskopike 2 panele

Materiali i derës së kabines: Inox Satin

Materiali i dyerve të katit: Inox Satin

Motori: Kleemann

Elektronika: Kleemann

Emergjencë: Automatike

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve

Afatet e ekzekutimit:36 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

	Zerat e kryerjes se riparim-sherbimeve per 4 ashensore	Pershkrimi i riparim- sherbimeve mirembajtese per 4 ashensore	Njesia	Sasia parashikuar ne 1 vit	Sasia e parashikuar ne 3 vite
1	Kabinae ashensorit	Gjendja e dyshernese. Mbyllja mekanike + elektrike e dyerve. Ndricimi i kabines. Butonat dhe llampat e prenotimit. Butonat hapje + mbyllje porte. Ventilatori & gjendja ne teresi.	Ore	105	315
2	Tavani i kabines	Gjendja e tavanit te kabines Kontroll, pastrim, regjistikim operatori, Kontakti i parashutes. Vajisje e shinave te kabina+k/peshave. Gominat e fiksimit kabine-arkade. Kontroll tokezimi kavo, kabine arkade. Gjendjen e fijeve flesibel.	Ore	105	315
3	Salla e makinerive	Pastrimi dhe ndricimi i salles. Prove rregullatorit, valvoles se renies. Kontroll gjendjes kavos se rregullatorit. Kontroll funksionimit te autornateve. Prove dispozitivit. Gjendja ne teresi e emergjences.	Ore	105	315

4	Arganello e ashensorit	Kontroll i nivelin e vajit ne reduktor. Kontroll i ventilatorit ftohes. Pastrimi i elektromotorit, reduktorit. Kontroll per xhoko vide-korone, pastrimi i tamburos se kontroll pulexhos el/motorit+devijimet, fortesise se sustes se frenitfrenit. Kontroll gjendjen e ferrotave te frenit.	Ore	105	315
5	Kafazi i ashensorit	Pastrimi, shtrengimi i stafave te shinave. Pastrimi, shtrengimi i dyerve te katit. Kontroll i stafave te petashuqeve. Ndricimi i kafazit. Tokezimi i shinave.	Ore	105	315
6	Kuadri i manovres	Kontroll zhurme leshues, rele etj. Shtrengim fije tek leshuesit dhe relet. Prove + rregjistrim termikun e thithjes. Kontroll tokezimit te kuadrit. Kontroll perqafimi i morsetave tek skeda. Pastrim skede, kontroll transformatori.	Ore	105	315
7	Arkaden	Kontroll dado tirante, morsetat e kavove. Kontroll morsetat e kavos se rregullatorit. Shtrengimi i bulonave te arkaden. Kontroll xhoko (hapsire) guarnicioneve Gjendja e tirantit, prova e parashutes. Kontroll arkades, k/peshes dhe kavot. Vaisje shinave, kabine + kundrapesha. Gjendja fizike ne teresi.	Ore	105	315
8	Gropa e ashensorit	Kontroll, pastrim i gropes. Kontroll i deviotorit dhe prizes. Kontroll i gjendjes se sustes + zinxhirit, Kontrol i distc. kabine-k/peshe-susta, Kontroll kontakti kavos se rregullatorit. Kontroll gjendjes pulexhos tendikavos. Kontroll bazamentit, korodimit shinave.	Ore	105	315
9	Portat e kateve	Kontroll i mbylljes mekanike dyerve. Kontakti elektrik, celesi i emergjences, pastrim i kases siper dhe i karelit.	Ore	105	315
10	Te pergjithshme	Kontroll-rregjistrim i hapesires se rulave. Kontroll per konsumim, shtrengim i patinave rulat e akopjimit. Prove kontroll i zhurmes se deres ne hapje butonave + llampat e kateve.	Ore	105	315

11	Ne cdo jave verifikime / kontrolle	Funksionimin e alarmit pa tension, Konsumin, zgjatjen, rreshqitjen e kavove, Tokezimin e ashensorit, Limitatorin e shpejtesise, Kontroll i qarqeve te sigurise dhe mbrojtjes. Distanca kat-kabine (max 30 mm). Valvolen e renies, Efikasitetin e termikut.	Ore	105	315
12	Materiale per mirembajtjen e ashensoreve	F.V. Graso ne nyjet levizese	Kg	10	30
13		F.V. Llampa 100 W per ndricimin e pusit	cope	14	42
14		F.V. Celsa te dyerve te kateve	cope	24	72
15		F.V. Celsa avarie te kabines	cope	8	24
16		F.V. Butona te thirrjes se kateve	cope	24	72
17		F.V. Rripa transmisioni te dyerve	cope	40	120
18		F.V. Llampa kabine per ndricim	cope	12	36
19		F.V. Sensore magnetik	cope	12	36
20		F.V. Automat termo/el.manj. Diferecial 2P, 220	cope	8	24
21		F.V. Automat magneto-termik 380 V, 25A, 4P,	cope	8	24
22		F.V. Butona tregues te dyerve te jashtme	cope	8	24
23		F.V. Butoneri e brendeshme	cope	8	24
24		F.V. Kabell fleksibel ashensori	MI	18	54
25		F.V. Kavo celiku fi 12 ashensoret	MI	300	900
26		F.V. Patina portash	cope	24	72
27		F.V. Rula per hapje dhe mbyllje dere	cope	24	72
28		F.V. Ferrota per frenat e motorrit	cope	20	60
29		F.V. Inverter dyersh	cope	4	12
30		F.V. Pult komandimi	cope	4	12
31		F.V. Leshues 63A	cope	4	12
32		F.V. Operator kabine	cope	4	12
33		F.V. Kuader manovre (panel komandimi)	cope	4	12
34		F.V. Panel ashensori VVVF (Paneli elektrik 15 kW)	cope	4	12
35		F.V. Motor mekanik kabine (24V D.C.)	cope	4	12
36		F.V. Fotocelule (12 V DC)	cope	6	18
37		F.V. Akses karte	cope	12	36
38		F.V. Kontaktet e dyerve te jashteme	cope	12	36
39		F.V. Display	cope	6	18

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Protokolli i mirembajtjes periodike:

1. Gjate seancave te mirembajtjes se rregullt mujore OE duhet te kryeje keto procese

kontrolli:

- Niveli i kabines (ndalja) ne kate:

Kontrolli i saktësisë së ndaljes nëpër kate

- Butoni i alarmit ne kabine:

Kontrolli i funksionimit te butonit

- Butonat e kateve dhe treguesit (display):

Kontrolli i funksionimit normal te tyre

- Kabina e Ashensorit:

Kontrolli i fiksimit te panelave dhe tavanit, kontrolli i nricimit, kontrolli i ndricimit te emergjences, butonave ne kabinë, kontrolli i rreshqitesave te kabines dhe vajerave, kutia e mergjences mbi kabinë, funksionimi i sensoreve.

- Dyert e jashtme te kateve:

Kontrolli dhe lubrifikimi

Kontrolli i kavos, rripit te motorit, integritetit dhe kompaktësia e komponenteve.

Kontrolli i hapësirës së derës

Kontrolli i paneleve te dyerve dhe shtrengimi i tyre ne mekanizmin e hapjes

Kontrolli i funksionimit te dyerve te jashtme te kateve.

Kontrolli i kasave te dyerve

Kontrolli i pragjeve te dyerve dhe pastrimi i tyre.

Kontrolli i dyerve dhe levizjes lirshem te tyre

Kontrolli i funksionimit tcelesave te hapjes se dyerve ne raste emergjente.

- Dyert e kabinës:

Kontrolli i hapjes dhe mbylljes se deres.

Kontrolli i mbylljes se kontaktit.

Kontrolli i mbylljes se mundshme.

Kontrolli i deres per levizje te lirshme

Kontrolli i binareve të deres.

Kontrolli i hapesires se deres.

Kontrolli i lubrifikimit.

Kontrolli i kavos, zinxhirit apo rripit.

Kontrolli i kompakesise semekanizmit te deres se kabines.

Kontrolli i funksionimit të senzoreve.

Kontrolli i pragut dhe pastrimi i tij.

Kontrolli i forces mbyllese te deres.

- Zona fundore e pusit te ashensorit:

Kontrolli i te gjithë komponenteve qe te jenete paster, te mos kene pluhur apo ndryshk.

Kontrolli i ndricimit te zones fundore të pusit.

Kontrollimi i nivelit te vajit ne mbledhesene vajit nga shinat.

- Buferët:

Kontrolli i vendosjes sekontaktit.

Kontrolli i fiksimitte“buffer”-it.

- Rregullatori i shpejtesise:

Kontrolli i gjendjes së rregullatorit te shpejtesise

Kontrolli i pozicionit dhe i fiksimit neshina/bazament

Kontrolli i kontaktit elektrik te rregullatorit në qarkun e sigurise

Kontrolli i paisjes me pesha për rregullatorin e shpejtesisë

Kontrolli i kavos dhe fiksimit i saj tek frenat e kabinës

- Frenat e kabinës ose nofullat (Safety gear / Pawl/ Clamping Devices):

Kontrolli i kontaktorit elektrik.

Kontrolli i funksionimit dhe distancës nga binari.

Kontrolli i lidhësve dhe shtrengimi.

Kontrolli i pjeseve levizëse për levizje të lira.

- Rreshqitesat e kabines:

Kontrolli i lubrifikimit (lyerjes me vaj ose me graso)

Kontrolli i kapësve dhe shtrëngimi.

Kontrolli i konsumit dhe nevoja për ndërrim (veshje).

- Kavot:

Kontrolli i elasticitetit dhe tensionit.

Kontrolli i lidhjeve korrekte.

Kontrolli shtrengimit të njëjtes të të gjithë kavove.

- Shinat:

Kontrolli i lubrifikimit (vajisjes) në pjesën aktive të shinave

Kontrolli i fiksimit nëpër stafa të shinave.

- Celesat fundore:

Kontrolli i funksionimit të tyre dhe pozicioni

- Lidhjet elektrike:

kontrollimi për vërtetimin e izolimeve dhe gjendjet e lidhjeve

- Bordi elektronik:

Kontrolli i kabinetit që të jetë i pastër, i thatë dhe pa pluhur.

Matja e rezistoreve, diodave, kapacitoreve etj, për vlerat nominale.

- Inverteri:

Kontrolli i gjendjes së inverterit dhe fiksimit në mur.

Gjendja e lidhjeve me motorin dhe me bordin elektronik.

Ekranet dhe treguesit e tjere per funksione të caktuara.

- Motori:

Kontrolli i kabllit furnizimit elektrik të motorit.

Kontrolli i frenave te motorit dhe aktivizimi/c'aktivizimi i tyre në kohë.

- Paisjet elektrike të sigurisë:

Kontrolli i funksionimit

Kontrolli i qarkut elektrik te sigurse.

Kontrolli i siguresave perkatese nëse janë të vendosura ne menyre korrekte.

- Sistemi emergjent i evakuimit:

Kontrolli i funksionit të sistemit emergjent te evakuimit

Ekipi sigurohet ne cdo vizite që ashensorët te lihen në gjendje të rregullt.

2. Mirembajtja e rregullt periodike e ashensorit

Mirembajtje e rregulle periodike e ashensorit perfshin:

1- Kontrollin njehere ne muaj te komponenteve te ashensorit sipas protokollit ne piken1
te specifikimeve teknike

2- Riparimin e defekteve qe vijne si efekt i perdorimit normal i ashensorit

3- Pergjigjen per raste emergjencash

Nderhyrjet per riparimin e defekteve te ashensoreve (kohe pune, pa perfshire pjeset qe mund te nderrohen) qe vijne si pasoje e funksionit normal te ashensorit* konsiderohen pjese e procesit standard te mirembajtjes dhe mbulohen nga tarifa e mirembajtjes se ashensorit.

Koha e punes, si dhe pjeset e kembimit per riparimin e defekteve qe vijne si efekt i:

☐ Keqperdorimit

☐ Pakujdesive

☐ Prezenes se lageshtires dhe ujit ne kafaz dhe komponente

☐ Perdorimit te ashensoreve per transport te objekteve/mallrave

nuk konsiderohen pjese e procesit standard te mirembajtjes dhe mbulohen nga tarifa e mirembajtjes se ashensorit.

*Defekte qe vijne nga funksionimi normal i ashensorit quhen te gjitha defektet qe nuk

shkaktohen nga keqperdorimi, perdorimi jo i kujdeshsem, luhatjet e energjise elektrike, lageshtira dhe uje ne elementet e ashensorit, ushtrimi i dhunes ne kabine, dyer etj, nderhyrja e personave te pa-autorizuar ne elemente te ashensorit, etj.

3.Njoftimi per raste defektesh

Per te siguruar venien ne pune sa me te shpejte te ashensorit ne raste defektesh, keto defekte duhet te njoftohen menjhere ne njerin nga numrat e Qendres se Thirrjes se Operatorit Ekonomik. Ky numer duhet te afishohet ne brendesi te kabines.

4.Nderhyrja nga persona te pa-autorizuar

Gjate validitetit te kontrates se mirembajtjes, personat te pa-autorizuar (qe nuk jane staf i Operatorit Ekonomik) e kane absolutisht te ndaluar te bejne mirembajtje, riparime apo cdo lloj nderhyrje tjeter ne ashensorin subjekt i kesaj kontrate.

5.Riparimet e defekteve

Ne raste defektesh, Operatori Ekonomik do te beje riparimin e tyre brenda nje kohe sa me te shkurter te mundshme. Ne raste defektesh ku pjese kembimi duhet te riparohen apo nderrohen, kthimi ne funksion i ashensorit do te varet nga koha e riparimit te defektit apo ardhjes se pjeses perkatese.

Operatori Ekonomik do te vere ne dispozicion te pales kontraktuese nje raport ne lidhje me defektin, pjeses se defektuar, koston dhe kohes se riparimit/ardhjes se ashensorit.

6.Lenia jashte funksionit e ashensorit

Ne rastet kur ekipi i servisimit konkludon se ashensori nuk eshte ne gjendje te rregullt, dhe se rrezikohet siguria e perdoruesve, stafit apo e ashensorit, ekipi duhet te nxjerr ashensorin jashte funksionit deri ne riparimin e problemit.

Personat pergjegjes nga Autoriteti Kontraktor njoftohen zyrtarisht per lenien e ashensorit jashte funksionit, arsyen si dhe kohen e parashikuar te kthimit ne funksion te ashensorit.

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: zyrat qendrore te OSHEE group sh.a

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 900,000 (nenteqind mijë) leke pa TVSH.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deshmi për:

Sherbime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 900,000 (nenteqind mijë) leke dhe që është që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- *Për shërbime të mëparshme të realizuara me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

- *Në rastin e shërbimeve të mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare:

ISO 9001 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme),

ISO 45001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të provojë që çdo pjesë furnizim vendosje (referuar preventivit të shërbimeve shtojca 7 e DT) duhet të ketë origjinë nga prodhuesi në përputhje me specifikimet teknike të ashensoreve që parashikohet të mirëmbahen sipas Shtojcës 5 të DT. Kjo e vërtetuar me autorizim mbështetje me pjesë këmbimi, lëshuar nga prodhuesi / distributori i autorizuar në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë licencën zbatimi NS 3-A për montimin e impianteve ngritëse dhe transportuese. Në përmbushje të kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën e zbatimit të shoqërisë.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të provojë që ka të paktën 5 të punësuar nga të cilët;

- dy teknike ashensori
- një inxhinier mekanik
- një elektrikist
- një mekanik

- ku një punonjës të jetë i certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”

Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- llogaritjet e muajit Qershor 2025

- Teknikët e ashensorit, elektrikistit dhe mekanikut, duhet të disponojnë certifikatën e trajnimit të sigurimit Teknik;

-inxhinieri mekanik duhet te jete i pajisur me diplome.

Per stafin e kerkuar operatori ekonomik duhet te dorezoje kontratat e punes.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____

